



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Kabinet of the Ministër

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	01-M	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot.No	S72/22
Nr. i Faqeve Br. Stranica No.Pages	- 01 -	Data: Datum: Date	08.02.22
PRISHTINË / A			No. 1

Nr. _____

Data: 08/02/2022

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, nenit 63, paragrafi 2 dhe nenit 93 të Ligjit Nr. 04/L-147 të Ligjit për Ujërat e Kosovës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 16/127 i datës 24/04/2013 për Caktimin e Zonave të Mbrojtura dhe Masat e Tyre Mbrojtëse për Burimin sipërfaqësor - Akumulimi i Badovcit, si dhe nenit 37 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-183, 2021 për Transportin Tokësor të Mallrave të Rrezikshme, nxjerr:

V E N D I M

1. Ndalohet qarkullimi automjeteve të cilat transportojnë materie kimike, karburante të lëngëta dhe materie tjera të rrezikshme në rrugën nacionale N 25.2, pjesa e segmentit rrugor përgjatë liqenit akumulues "Badovci".
2. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Rrugëve që të vendosin sinjalizimin vertikal mbi kufizimin e qarkullimit të automjeteve sipas pikës 1 të këtij vendim.
3. Zbatimi i ndalesës nga pika 1 e këtij vendimi fillon nga data 1 Mars 2022.



Liburn Aliu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Vendimi t'i dërgohet:

- Kabinetit të Ministririt;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit për Menaxhimin e Rrugëve;
- Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Arkivit të MMPHI-së .